



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1465/7 prot

Datë 30.08.2024

**V E N D I M**  
**Nr. 1154/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri  
Fiorent Zguro  
Gjergj Mersini

Kryetar  
Nënkryetar  
Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.08.2024 me

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Kthella” SHPK, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-04311-05-10-2024, me objekt: “*Blerje karburanti, per nevoja te Agjencise se Puneve Publike dhe Mirembajtjes*”, me fond limit 8,676,667 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 24.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për Skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “AEK Munella” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

**Autoriteti Kontraktor:**

Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes, me adresë: Sheshi “Abat Doçi”, Rrëshen

**Ankimues:**

“AEK Munella” SHPK, me NIPT (J98926001P), me adresë: Rrëshen, Km 1.2, Rrëshen, Ura e Fanit në krahun e djathtë, Mirditë

**Subjekte të Interesuara:**

“Kthella” SHPK, me NIPT (J69303023D), me adresë: Rrëshen, Kompleksi “Kthella Resort”, Rruga “Shën

Vicenzo De Paolo”, përballë varrezava të Qytetit Rrëshen, Mirditë

**Baza Ligjore:**

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se ankesat e operatorit ekonomik ankimues janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tij duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 13.05.2024 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-04311-05-10-2024, me objekt: “*Blerje karburanti, për nevoja të Agjencisë së Punëve Publike dhe Mirembajtjes*”, me fond limit 8,676,667 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 24.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Punëve Publike dhe Mirembajtjes.

II.2. Në datën 29.05.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), sipas marzhit të fitimit, përkatësisht:

1. “Kthella” SHPK	14.9	lekë,	kualifikuar
2. “AEK Munella” SHPK	15	lekë,	kualifikuar
3. “Kevuçi” SHPK	24	lekë,	kualifikuar

II.3. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, rezulton se në datë 31.05.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraparak.

II.4. Pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4175, datë 06.06.2014 dhe me nr. protokollin 1465/2024 datë 07.06.2024 e operatorit ekonomik “AEK Munella” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraparak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Kthella” SHPK. Konkretisht operatori ekonomik ankimues pretendon: “*[...] Autoriteti Kontraktor kur vlereson ofertat me sakt komisioni i vlerësimit të oferta duhet të ruaj frymen e ligjit dhe ta rrespektoj atë dhe duke kryer të gjitha verifikimet që legjislacioni ja ve në dispozicion para se të shpallë rezultatin e ofertave.*

*SE pari komisioni i vlerësimit të ofertave para se të shpall vlerësimin e ofertave duhet të verifikoj të gjitha kriterit të cilat janë vendosur në dokumentat standart të tenderit duke i verifikuar me rigorozitet a janë perbushur ato sidomos shlyerja e taksave si vendore dhe ato të institucioneve të tjera.*

*Komisioni i vlerësimit të ofertës ka të gjithë mekanizmat ligjore që të verifikoj a janë shlyer Taksat Vendore, a janë paguar Sigurimet shoqërore , a janë paguar tatimin mbi vlerën e shtuar(TVSH), mos ka ndonjë vendim gjykatë për shlyerje detyrimesh etj.*

*Pra autoriteti kontraktor para se të shpall vlerësimin e ofertës dhe verifikimin i të gjithave kriterëve si dhe rrespektimin e ligjit ,frymen e saj shapll ofertuesin me të mire, jo gjithmon oferta me e ulët është me e mira.*

*Kemi dyshime se komisioni i vlerësimit të ofertës nuk karrespektuar ligjin dhe frymen e tij i cili përcakton konkretisht:*

*NE nenin 2 të Ligji nr. 162/2020 për prokurimin publikë parashikohet :*

*Qëllim i këtij ligji është:*

*A) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*

*B) të sigurojë mirepërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*

- C) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik;
- Ç) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike;
- D) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithë operatorët ekonomike, pjesemarrës ne procedurat e prokurimit publik;
- Dh) te siguroje integritet, besim publik dhe transparence ne procedurat e prokurimit publik.
- NE nenin 3 te Ligji nr. 162/2020 per prokurimin publike parashikohet :
1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojne trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per operatorët ekonomike, si dhe veprojne me transparence e ne menyre proporcionale.
  2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet te shmangin fushen e zbatimit te ketij ligji ose te ngushtojne ne menyre artificiale konkurrencen. Konkurrenca konsiderohet se eshte ngushtuar artificialisht kur prokurimi pergatitet me qellimin per te favorizuar ose demtuar ne menyre te padrejte operatore ekonomike te caktuar.
  3. Autoritetet dhe entet kontraktore jane te detyruara te zbatojne detyrimet e percaktuara ne legjislacionin mjedisor, social e te punes dhe ne dispozitat e marreveshjeve dhe konventat nderkombetare, te ratifikuara ne perputhje me kushtetuten.

#### **KERKESA 1**

Shtojca 6

#### **FORMULARI I SASISÀ DHE GRAFIKUT TÀ LÀVRIMIT**

Sasia e pritshme e mallit qe kerkohet:

Kerkohen gjithsej 58 186 litra Gazoil (Diesel) - 10 ppm USLD si dhe 641 litra benzine.

Nr. Emertimi Njesia Sasia

2 Blerje karburant naftë per nevoja te APPM, Bashkia mirdite Litra 58186

2 Blerje karburant benzine per nevojat e APPM, Bashkia mirdite Litra 641

#### **SHUMA**

Afatet e levrimit:

Afati i levrimit do te jete nga nenshkrimi i kontrates e ne vazhdim sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor.

Shenim:

1. Sasite e kerkuara nga AK, jane sasi te pritshme, e llogaritur ne baze te dhenave nga Drejtoria e Doganave te publikuar ne buletin. Kjo sasi mund te jete e ndryshueshme ne varesi te cmimit te publikuar nga APP ne buletin javor.
2. Do te jete AK ajo qe do te percaktoje sasite perkatese gjate zbatimit te kontrates. Operatoret do te ofertojne me marzh fitimi te shprehur ne lek per liter. Ky marzh do te jete I pandryshuar gjate gjithë realizimit te kontratave. Sasia e kerkuar nga autoriteti eshte sasi e pritshme, per te cilen autoriteti do te shprehet ne momentin e nenshkrimet te kontrates.
3. Formulari i ofertes te perfshije element si me poshte:
  - A) Çmimin e burses, levruar sipas kushtit CIF-shqiperi, i cili dergohet per publikim Ádo jave nga Drejtoria e pergjithshme e Doganave ne Buletinin e Njoftime Publike;
  - B) elementet fiskale;
  - C) normen e fitimit te shprehur ne vlere absolute, e cila duhet te jete e pandryshuar gjate gjithë kohes se zbatimit te kontrates.e
4. Gjate kohes se zbatimit te kontrates per furnizimin me karburant, gasoil, benzol dhe karburant per ngrohje, vlere absolute e normes se fitimit nuk do te ndryshoje gjate

*ekzekutimit te kontrates, ne rast te luhatjes se Ámimeve. Nese Ámimi gjate kohes se zbatimit te kontrates per*

*Furnizimin me karburant, gasoil, benzol dhe karburant per ngrohje ndryshon ne raport me Ámimin e kontrates, atehere autoritetet/entet kontraktore duhet te bejne likuidimin e mallit sipas faturave periodike te shitjes, mbeshetur ne Ámimin e burses te publikuar ne Buletinin e Njoftimeve Publike, i derguar nga Drejtoria e pergjithshme e Doganave, levruar sipas kushtit CIF-shqiperi ne kete moment Autoriteti kontraktor, para pagimit te fatures se mallit duhet te kontrolloje perqindjen e pranuar te rritjes apo te uljes te Ámimit te burses, te publikuar ne Buletinin e Njoftimeve Publike, derguar nga Drejtoria e pergjithshme e Doganave levruar sipas kushtit CIF-shqiperi, ne momentin e shtijes se mallit, objekt kontrate, autoriteteve kontraktore, si dhe cilesine e mallit te levruar, nese eshte e njejte me ate te cilen eshte shpallur fitues kontraktori.*

*Duke permbushur kriteret qe kerkohen ne dokumentat standart te tenderit pergaditja e oferte behet duke rrespektuar kriteret e kerkuara dhe duke vendosur marzhin e fitimi i cili ka nje rrol*

*Perfundimtare te percaktimit te saj.*

*Nga sa me siper dhe e riperserisim qe diferenca midis dy ofertave eshte shume dyshuese dhe se jemi mos abztimit te ;*

*NE nenin 2 te Ligji nr. 162/2020 per prokurimin publike parashikohet :*

*Qellim i ketij ligji eshte:*

*A) te rrise efiácencen dhe efikasitetin ne procedurat e prokurimit publik;*

*B) te siguroje mireperdorim te fondeve publike dhe te ule shpenzimet procedurale;*

*C) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik;*

*Ç) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike;*

*D) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike, pjesemarres ne procedurat e prokurimit publik;*

*Dh) te siguroje integritet, besim publik dhe transparence ne procedurat e prokurimit publik.*

*NE nenin 3 te Ligji nr. 162/2020 per prokurimin publike parashikohet :*

*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojne trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per operatoret ekonomike, si dhe veprojne me transparence e ne menyre proporcionale.*

*2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet te shmangin fushen e zbatimit te ketij ligji ose te ngushtojne ne menyre artificiale konkurrencen. Konkurrenca konsiderohet se eshte ngushtuar artificialisht kur prokurimi pergatitet me qellimin per te favorizuar ose demtuar ne menyre te padrejte operatore ekonomike te caktuar.*

*3. Autoritetet dhe entet kontraktore jane te detyruara te zbatojne detyrimet e percaktuara ne legjislacionin mjedisor, social e te punes dhe ne dispozitat e marreveshjeve dhe konventat nderkombetare, te ratifikuara ne perputhje me kushtetuten. ”*

II.4.1. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr.1465/2 prot., datë 10.06.2024 lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues.

II.4.2. Njëpërmjet shkresës me nr.1465/3 prot., datë 02.08.2024, me objekt “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesat e operatorit ekonomik “AEK Munella” SHPK”, Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar autoritetit kontraktor duke kërkuar informacion si më poshtë:

*“[...] Me anë të shkresës Nr.388 prot., datë 27.06.2024, protokolluar me tonë me nr. 1594/3 prot., datë 26.06.2024, institucioni juaj ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vetëm aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimes “AEK Munella” SHPK, ku konstatohet se ankesa e këtij të fundit është refuzuar, por nuk është dërguar asnjë informacion në lidhje me procedurën e prokurimit, si dhe lidhur me trajtimin e ankimit elektronik me nr. A/2024/4175, datë 06.06.2014 dhe me nr. protokollin 1465/2024 datë 07.06.2024, të operatorit ekonomik “AEK Munella” SHPK.*

*Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 114 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, të gjithë informacionin e hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të paraqitura në këtë procedurë prokurimi, duke qenë se nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik janë kryer disa rivlerësimi, si dhe akti i trajtimit të ankimit elektronik me nr. A/2024/4175, datë 06.06.2014 dhe me nr. protokollin 1465/2024 datë 07.06.2024, të operatorit ekonomik “AEK Munella” SHPK.*

*Akoma më tej, nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëngjitur ankimit elektronik A/2024/4221, dhe nr. Protokollin 1594/2024, datë 14.06.2024, të operatori ekonomik “AEK Munella” SHPK konstatohet se formulari i ankesës është me të meta, pasi operatori ekonomik ka paraqitur dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës për ankimin elektronik me nr. A/2024/4175, datë 06.06.2014 dhe me nr. protokollin 1465/2024 dhe nuk ka dorëzuar pagesë për ankesën me nr. protokollin 1594/2024 datë 14.06.2024.*

*Për sa më sipër, me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik kërkon të informohet në lidhje me administrimin e kësaj anekese pranë institucionit tuaj si dhe veprimet procedurale të kryera nga ana juaj sipas parashikimeve të nenit 111/3 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 94/4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.”*

II.4.3. Njëpërmjet shkresës me nr. 440/1 prot., datë 06.08.2024, protokolluar me tonën me nr. 1465/4 prot., datë 07.08.2024 me objekt “Shkresë përcjellëse” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i administruar pranë autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.4.4. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor kontraktor njëpërmjet shkresës së mësipërme, ndër të tjera, bashkëlidhur autoriteti kontraktor ka dorëzuar “Vendim i shqyrtimit të vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave mbi ankesën e “AEK Munella”, me nr.340/1 prot., datë 06.06.2024, ku rezulton se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka vendosur rivlerësimin e procedurës së prokurimit, duke vendosur skualifikimin e operatorit ekonomik “AEK Munella” SHPK.

II.5. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, si dhe verifikimi në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.), rezulton se, në datë 10.06.2024, autoriteti kontraktor ka kyer në SPE rivlerësimin e procedurës, përkatësisht:

1. “Kthella” SHPK	14.9	lekë,	kualifikuar
2. “AEK Munella” SHPK	15	lekë,	skualifikuar
3. “Kevuçi” SHPK	24	lekë,	kualifikuar

Operatori ekonomik “AEK Munella” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë:

- nuk ka arritur te paraqese asnje dokumentacion per furnizime te ngjashme
- nuk ka aritur te paraqese bilancin e v 2020
- Shtojca 7 [Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

#### **FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

##### **1. KRITERET E PËRZGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

*Ofertuesi deklaron se: a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv); c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së; ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së; d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së; e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës; gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip. Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit*

ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur. Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës. Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore. Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër. Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet : → Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit. → Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

- nuk ka arritur të depozitojë asnjë dokument që vërteton se ka realizuar furnizime të ngjashme Gjithashtu nuk ka depozituar bilancin e v 2020
- nuk ka arritur të përmbushë kriteret për kualifikim sipas dst pika 2.2.2 dhe pika 2.3

II.6. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, rezulton se në datë 13.06.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraprak.

II.7. Në datën 14.06.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, ka administruar ankesën me nr. A/2024/4221, dhe nr. Protokolli 1594/2024, datë 14.06.2024, të operatorit ekonomik “AEK Munella” SHPK, i cili kundërshton skualifikimin e ofertës së tij ekonomike. Nga shqyrtimi i ankesës, rezulton se kjo e fundit është dorëzuar me të meta, pasi është paraqitur i njëjti dokument bankar që vërtetin pagesën për ankimin elektronik me nr. A/2024/4175, datë 06.06.2014 dhe me nr. protokolli 1465/2024 datë 07.06.2024 e operatorit ekonomik “AEK Munella” SHPK.

Operatori ekonomik, pretendon konkretisht: “Me datën 10.06.2024 ne sistemin elektronik të prokurimit publik marrim njoftim të ri të një rivlersim të ri të ofertës sonë si më poshtë: Sqarim se me datën 29.05.2024 autoriteti kontraktor ka bërë një vlersim ku ofertën tonë e kualifikon.

Me datën 10.06.2024 autoriteti kontraktor nuk e kualifikon ofertën tonë.

Mendojmë se ka shkelje të rënda të ligjit.

Një gje e gjykuar nuk mund të gjykohet për së dyti.

Ne tablën e sipërme shikojmë që ofertat nuk janë të njejta me vlerësimin e ofertës së datës 29.05.2024. Shikojmë që ka diferenca.

NË arsyet e skualifikimit të ofertës sonë janë këto pretendime:

1. Nuk është depozituar bilanci i 2020

2. Nuk përmbush kriterin kontrat e ngjashme

A. Kërkesa ku nuk është depozituar bilanci i 2020, është e vertet që ne nuk e kemi paraqitur për arsyen se jemi në vitin financiar 2024 dhe për rrjedhojë sipas legjislacionit në fuqi nuk kërkohet që ku bilanc duhet të paraqitet se tre vitet e fundit që duhej të kërkohesh janë 2021



2022 20223. *Ku kriter nuk duhej të ishte vendosur nga autoriteti kontraktor pasi sipas legjislacionit në fuqi kërkohet tre vitet e fundit të pasqyrave financiare.*

*B. Kontrata e ngjashme sipas kriterit 2.3 Kapaciteti teknik:*

*2.3.1 për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së perlllogaritur të kontratës që prokurohet (neni 55/4/b i vkm-se 285/2021).*

*Kjo pikë përmbushet me vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

*NË rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

*Mendojmë se e kemi përmbushur këtë kriter duke paraqitur kontrata e furnizimit me subjektin privat si dhe faturat sic kërkohet në DST.*

*Mendojmë se jemi para faktit se ky objekt prokurorimi e ka pasur të paracaktuar fituesin.*

*Autoriteti Kontraktor nuk mund të beje dy vlerësim duke e kualifikuar një herë dhe skalifikuar për së dyti, duke ndryshuar rrezultatit e ofertës.”*

II.7.1. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr.1594/2 prot., datë 18.06.2024 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “AEK Munella” SHPK.

II.7.2. Nëpërmjet shkresës me nr. 388 prot., datë 27.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 1594/3 prot., datë 28.06.2024 me objekt “Informacion mbi procedurën e prokurimit “Blerje karburant (naftë dhe benzinë) për nevojat e Agjencisë së Punëve Publike dhe Mirënjatjes”, bashkëlidhur është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë ankimues, me nr. 382 prot., datë 26.06.2024, ku konstatohet se ankesa e këtij të fundit është refuzuar.

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 të “Ligjit për Prokurimin Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

## Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “AEK Munella” SHPK në ankimin elektronik me A/2024/4175, datë 06.06.2014 dhe me nr. protokolli 1465/2024 datë 07.06.2024, për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Kthella” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se në ankesën drejtuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë KPP, operatori ekonomik ankimues nuk parashtron fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori*, duke ngritur dyshime e hamendësime, lidhur me plotësimin e kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike nga opeatori ekonomik “Kthella” SHPK në procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale, duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 48, “Kushtet formale të ankesës”, pika 3:

*Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”.*

Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon, se ankimuesi duhej të kishte shoqëruar pretendimet e tij me prova, indicie dhe argumente, në bazë të të cilave do të shqyrtohen këto pretendime. Vlen të ritheksojmë, se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë, se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për kualifikimin e padrejtë të shoqërisë “Kthella” SHPK. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjitha apo shumicën e elementeve përbërëse të dokumenteve të tenderit, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si i tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik, refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument.

Rrjedhimisht pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, nuk merren në shqyrtim.

III.2. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik “AEK Munella” SHPK, në ankimin elektronik me A/2024/4221, dhe nr. Protokolli 1594/2024, datë 14.06.2024, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, nisur nga veprimet e KSHA se autoritetit kontraktor për rivlerësimin kryesisht të procedurës së prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor (KSHA-së), për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoriteti kontraktor (KSHA), gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.2.1. Në datën 13.05.2024 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-04311-05-10-2024, me objekt: “Blerje karburanti, per nevoja te Agjencise se Puneve Publike dhe Mirembajtjes”, me fond limit 8,676,667 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 24.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes.

III.2.2. Në datën 29.05.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), sipas marzhit të fitimit, përkatësisht:

4. “Kthella” SHPK	14.9	lekë,	kualifikuar
5. “AEK Munella” SHPK	15	lekë,	kualifikuar
6. “Kevuçi” SHPK	24	lekë,	kualifikuar

III.2.3. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, rezulton se në datë 31.05.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraparak.

III.2.4. Pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4175, datë 06.06.2014 dhe me nr. protokolli 1465/2024 datë 07.06.2024 e operatorit ekonomik “AEK Munella” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraparak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Kthella” SHPK.

III.2.5. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr.1465/2 prot., datë 10.06.2024 lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues.

III.2.6. Njëpërmjet shkresës me nr.1465/3 prot., datë 02.08.2024, me objekt “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesat e operatorit ekonomik “AEK Munella” SHPK”, Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar autoritetit kontraktor duke kërkuar informacion si më poshtë:

*“[...] Me anë të shkresës Nr.388 prot., datë 27.06.2024, protokolluar me tonë me nr. 1594/3 prot., datë 26.06.2024, institucioni juaj ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vetëm aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimes “AEK Munella” SHPK, ku konstatohet se ankesa e këtij të fundit është refuzuar, por nuk është dërguar asnjë informacion në lidhje me procedurën e prokurimit, si dhe lidhur me trajtimin e ankimit elektronik me nr. A/2024/4175, datë 06.06.2014 dhe me nr. protokollin 1465/2024 datë 07.06.2024, të operatorit ekonomik “AEK Munella” SHPK.*

*Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 114 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, të gjithë informacionin e hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të paraqitura në këtë procedurë prokurimi, duke qenë se nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik janë kryer disa rivlerësime, si dhe akti i trajtimit të ankimit elektronik me nr. A/2024/4175, datë 06.06.2014 dhe me nr. protokollin 1465/2024 datë 07.06.2024, të operatorit ekonomik “AEK Munella” SHPK.*

*Akoma më tej, nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëngjitur ankimit elektronik A/2024/4221, dhe nr. Protokollin 1594/2024, datë 14.06.2024, të operatori ekonomik “AEK Munella” SHPK konstatohet se formulari i ankesës është me të meta, pasi operatori ekonomik ka paraqitur dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës për ankimin elektronik me nr. A/2024/4175, datë 06.06.2014 dhe me nr. protokollin 1465/2024 dhe nuk ka dorëzuar pagesë për ankesën me nr. protokollin 1594/2024 datë 14.06.2024.*

*Për sa më sipër, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik kërkon të informohet në lidhje me administrimin e kësaj ankese pranë institucionit tuaj si dhe veprimet procedurale të kryera nga ana juaj sipas parashikimeve të nenit 111/3 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 94/4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.”*

III.2.7. Njëpërmjet shkresës me nr. 440/1 prot., datë 06.08.2024, protokolluar me tonën me nr. 1465/4 prot., datë 07.08.2024 me objekt “Shkresë përcjellëse” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i administruar pranë autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.2.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor kontraktor njëpërmjet shkresës së mësipërme, ndër të tjera, bashkëlidhur autoriteti kontraktor ka dorëzuar “Vendim i shqyrtimit të vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave mbi ankesën e “AEK Munella”, me nr.340/1 prot., datë 06.06.2024, ku rezulton se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka vendosur rivlerësimin e procedurës së prokurimit, duke vendosur skualifikimin e operatorit ekonomik “AEK Munella” SHPK.

III.2.9 Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, si dhe verifikimi në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.), rezulton se, në datë 10.06.2024, autoriteti kontraktor ka kyer në SPE rivlerësimin e procedurës, përkatësisht:

4. “Kthella” SHPK	14.9	lekë,	kualifikuar
5. “AEK Munella” SHPK	15	lekë,	skualifikuar
6. “Kevuçi” SHPK	24	lekë,	kualifikuar

Operatori ekonomik “AEK Munella” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë:

- nuk ka arritur te paraqese asnje dokumentacion per furnizime te ngjashme
- nuk ka aritur te paraqese bilancin e v 2020
- Shtojca 7 [Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

#### **FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

##### **2. KRITERET E PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

*Ofertuesi deklaron se: a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv); c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së; ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së; d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së; e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës; gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituruar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip. Këto kritere duhet të*

*përbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur. Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës. Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore. Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër. Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet : → Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit. → Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.*

- *nuk ka arritur të depozitojë asnjë dokument që vërteton se ka realizuar furnizime të ngjashme Gjithashtu nuk ka depozituar bilancin e v 2020*
- *nuk ka arritur të përmbushë kriteret për kualifikim sipas dst pika 2.2.2 dhe pika 2.3*

III.2.10. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, rezulton se në datë 13.06.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraprak.

III.2.11. Në datën 14.06.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, ka administruar ankesën me nr. A/2024/4221, dhe nr. Protokolli 1594/2024, datë 14.06.2024, të operatorit ekonomik “AEK Munella” SHPK, i cili kundërshton skualifikimin e ofertës së tij ekonomike.

III.2.12. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr.1594/2 prot., datë 18.06.2024 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “AEK Munella” SHPK.

III.2.13. Nëpërmjet shkresës me nr. 388 prot., datë 27.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 1594/3 prot., datë 28.06.2024 me objekt “Informacion mbi procedurën e prokurimit “Blerje karburant (naftë dhe benzinë) për nevojat e Agjencisë së Punëve Publike dhe Mirënjatjes”, bashkëlidhur është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë ankimues, me nr. 382 prot., datë 26.06.2024, ku konstatohet se ankesa e këtij të fundit është refuzuar.

III.2.14. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.2.15. Ndërkohe në nenin 3 “Parime të Përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.16. Në udhëzimin nr. 07, datë 30.07.2021 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike”, parashikohet shprehimisht se:

*Pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga të gjithë anëtarët e KVO për të gjitha ofertat e dorëzuara nga operatorët ekonomikë, anëtari i autorizuar i njësisë së prokurimit duhet të bëjë në sistem mbylljen e fazës së vlerësimit të ofertave në sistem. Në këtë moment sistemi iu dërgon në mënyrë elektronike automatikisht njoftimin mbi klasifikimin e gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.*

III.2.17. Në nenin 80 pika 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:” përcaktohet se : “1. Kontratat jepen mbi bazën e kritereve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura;

b) operatori ekonomik, që ka dorëzuar ofertën, përmbush kriteret e kualifikimit e të përzgjedhjes dhe nuk ndodhet në ndonjë nga situatat që përbëjnë shkak për skualifikim.

2. Autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin refuzimin e ofertës, pavarësisht vlerës së saj, nëse vlerësohet se oferta e paraqitur nuk është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit vendas, marrëveshjeve ndërkombëtare ose legjislacionit vendas në fushën e mjedisit, mbrojtjes shoqërore dhe punës.

3. *Autoritetet ose entet kontraktore i shqyrtojnë ofertat e paraqitura bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë dhe legjislacionin përkatës në fuqi.*”

III.2.18. Në nenin 82 pika 1 dhe 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar përcaktohet se: “

1. *Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 20 (njëzet) ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuar ndryshe në këto rregulla.*

*Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve.*

2. *Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.*

*Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:*

i. *“Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;*

ii. *“Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe*

iii. *“Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.*

*Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.”*

III.2.19. Në nenin 100, pika 2 dhe 3 “Afatet e shqyrtimit të ankesave nga autoriteti/enti kontraktor” të VKM-së nr. 265, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “

2. *Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti/enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur, brenda 5 (pesë) ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

*Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti/enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur, brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113, të LPP-së, për paraqitjen e argumenteve të tyre.*



3. Në rastin kur, për shqyrtimin e ankesës, autoriteti/enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, ndërpritet, dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar, afati nuk duhet të tejkalojë 30 (tridhjetë) ditë.”

III.2.20. Në nenin 101, “Hapat për shqyrtimin e ankesave në autoritetin/entin kontraktor” të VKM-së nr. 265, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti/enti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm:

1. Titullari i autoritetit/entit kontraktor, me urdhër të veçantë, cakton një person ose ngrre një komision të përbërë nga të paktën 3 (tre) persona për shqyrtimin e ankesës.

*Të paktën njëri nga anëtarët e komisionit për shqyrtimin e ankesës duhet të jetë ekspert i fushës për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim.*

*Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit për të cilin është paraqitur ankesa.*

*Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit/entit kontraktor mund t’ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave ose ekspertit të fushës, anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave.*

2. Personi përgjegjës për prokurimin duhet të kujdeset që të njoftojë ankimuesit dhe operatorët ekonomikë të interesuar, të përfshirë në proces për çdo vendim në procesin e shqyrtimit të ankesës edhe në adresën elektronike të përcaktuar prej tyre në formularin e ankesës, jo më vonë se ditën e nesërme të punës pas marrjes së çdo vendimi.
3. Në rastin kur ankesa është pranuar plotësisht dhe nuk ka pasur argumente nga operatorët ekonomikë të interesuar, titullari i autoritetit/entit kontraktor njofton Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me këtë vendimmarrje dhe adreson zbatimin pas marrjes së vendimit deklarativ nga Komisioni i Prokurimit Publik.
4. Në rastet kur afatet kohore të procedurës së prokurimit, për të cilat janë njoftuar ofertuesit, ndryshojnë për shkak të marrjes parasysh të ankesës, autoriteti/enti kontraktor u shpërndan ofertuesve një njoftim të posaçëm, ku jepen arsyet për zgjatjen e këtyre afateve.”

III.2.21. Ndërsa në nenin 102, pika 2 “Vendimet e autoritetit/entit kontraktor në përfundim të shqyrtimit të ankesave” të VKM-së nr. 265, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet se:

- “2. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.”

III.2.22. Sa më sipër, nisur nga rasti konkret, konstatohet se operatori ekonomik ankimues “AEK Munella” SHPK, në vlerësimin e datës 29.05.2024, rezulton i kualifikuar në procedurën e prokurimit. Në datë 31.05.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraprak, ku operatori ekonomik “AEK Munella” SHPK në datë 06.06.2024 ka

paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe KPP-së duke kërkuar skualifikimin e operatorit ekonomik “Kthella” SHPK me ofertë më të ulët se e tij.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga autoritetit kontraktor konstatohet se, KSHA në aktin e trajtimit të ankesës, me nr. 340/1 prot., datë 06.06.2024, nuk ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues, por ka vendosur rivlerësimin e ofertave pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimit, duke skualifikuar operatorin ekonomik “AEK Munella” SHPK dhe duke lënë të kualifikuar dy operatorët e tjerë pjesëmarrës në këtë procedurë.

Bazuar në këtë vendim të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, autoriteti kontraktor në datë 10.06.2024 ka kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit, duke skualifikuar operatorin ekonomik “AEK Munella” SHPK dhe në datë 13.06.2024 ka publikuar në SPE Njoftimin e Fituesit Paraprak.

Në datën 14.06.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, ka administruar ankesën me nr. A/2024/4221, dhe nr. Protokolli 1594/2024, datë 14.06.2024, të operatorit ekonomik “AEK Munella” SHPK, i cili kundërshton skualifikimin e ofertës së tij ekonomike. Nga shqyrtimi i ankesës, rezulton se kjo e fundit është dorëzuar me të meta, pasi është paraqitur i njëjti dokument bankar që vërtetën pagesën për ankimin elektronik me nr. A/2024/4175, datë 06.06.2014 dhe me nr. protokolli 1465/2024 datë 07.06.2024 e operatorit ekonomik “AEK Munella” SHPK.

III.2.23. Sa më sipër parashtruar, gjykojmë se, në rastin konkret, Komisioni gjykon, se KSHA e autoritetit kontraktor me vendimin nr. 340/1 prot., datë 06.06.2024, “Për rivlerësim procedure”, në të cilin ka vendosur kryesisht rivlerësimin e procedurës së prokurimit, si dhe skualifikimin e operatorit ekonomik “AEK Munella” SHPK, ka kryer shkelje të cilat cenojnë ligjshmërinë e procedurave të prokurimit publik në fazën e e rishikimit administrativ nga një trupë e përcaktuar nga ligji dhe rregullat e prokurimit publik, siç është KSHA e autoritetit kontraktor, si dhe cenojnë haptazi sigurinë juridike të subjekteve të cilët shfaqen në cilësinë e ankimuesve apo subjekteve të interesuara në një prokurim.

Në rastin konkret, nisur nga arsyet e parashtruara nga Komisioni Shqyrtimit të Ankesës në aktin e trajtimit të ankesës nr. 340/1, datë 06.06.2024 të operatorit ekonomik “AEK Munella” SHPK, së pari KPP vëren se, KSHA në asnjë moment nuk është shprehur mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, por apriori ka vendosur rivlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik pjesëmarrës, duke vendosur skualifikimin e vetë ankimuesit.

Së dyti, gjykojmë se momenti procedural i vlerësimit të dokumentacionit mbi kriteret e kualifikimit, të dorëzuar në SPE, duhet të ishte data 29.05.2024.2024, datë në të cilën referuar dhe sistemit prokurimeve elektronike rezulton të jetë përmbyllur dhe procesi i vlerësimit të ofertave nga ana komisionit të vlerësimit të ofertave dhe njoftimi i ofertuesve në lidhje me kualifikimin/skualifikimin e tyre. Jo më kot ligjvënësi, në varësi të llojit të procedurës, ka parashikuar një afat kohor (20 ose 15 ditë) për procesin e vlerësimit të ofertave duke dhënë garanci për secilën prej palëve, KVO nga njëra anë për kryerjen e një vlerësimi të thelluar e transparent dhe me mundësinë edhe të kryerjes së verifikimeve pranë palëve të treta ose sqarimeve nga operatorët ekonomikë sa herë lind nevoja, dhe operatorëve ekonomikë pjesëmarrës që pas procesit të vlerësimit të ofertave dhe publikimit të njoftimit të fituesit paraprak apo anulimit të procedurës të kenë mundësi të mbrojnë interesat e ligjshëm duke ushtruar të drejtën e ankimit në autoritet kontraktor dhe në KPP. Në këtë kuadër KPP gjykon,

se brenda periudhës kohore që ligji parashikon, KVO e autoritetit kontraktor ka patur në dipozicion momentin procedural për kryerjen e verifikimeve apo sqarimeve të nevojshme për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme apo të veçanta të kualifikimit, derisa të konkludonte me mbylljen e procesit të vlerësimit në sistemin e prokurimit elektronik me datë 29.05.2024, ku operatori ekonomik “AEK Munella” SHPK rezultoi i kualifikuar në procedurën e prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (*Neni 4 i K.pr. Administrative*). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Gjithashtu KPP gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar afate strikte kohore për zhvillimin e procedurave të prokurimit në përgjithësi dhe në veçanti në lidhje me institutin e ankimit administrativ, të rishikimit të vendimmarrjes së autoritetit kontraktor. Në interpretim sistematik (domethënjen e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit gjykon se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor (rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh.A (Komisioni i Shqyrtimit të Ofertave).

Në rastin konkret nga verifikimet e kryera rezultoi se arsyet e reja të skualifikimit të evidentuara në aktin e trajtimit të ankesës nr. 340/1, datë 06.06.2024 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës janë jashtë tagrit dhe kompetencave të KSHA-së duke konstatuar dhe shtuar arsye skualifikimi për operatorin ekonomik ankimues “AEK Munella” SHPK (i cili në vlerësimin e datës 29.05.2024 rezultoi i kualifikuar) dhe jo duke ju përmbajtur objektit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues. Komisioni gjykon se arsyet e reja të skualifikimit dhënë nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, në tejkalim të kompetencave që u jep shprehimisht neni 94 i VKM nr. 285 datë 19.05.2021 i ndryshuar, nuk sjellin asnjë pasojë mbi operatorin ekonomik ankimues.

Në nenin 108 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, parashikon se “*Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik; ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit; b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën veprë penale; c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal; ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.*” Gjithashtu, në nenin 111 të K.Pr.A parashikohet se “*Organi publik ka*

*detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nëse vjen në dijeni për rastet e parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi”. Ndër karakteristikat thelbësore të veprimit juridik absolutisht të pavlefshëm përmendim: (i) veprimi juridik që është absolutisht i pavlefshëm nuk shkakton pasojat juridike që synojnë palët; (ii) ai nuk ka fuqinë juridike të një veprimi juridik të vlefshëm; (iv) veprimi juridik i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm me asnjë veprim të mëpasshëm, as edhe kur ekziston vullneti i palëve (me aprovim, miratim), as me kalimin e kohës së parashkrimit dhe as me zhdukjen më vonë të shkakut të pavlefshmërisë (quod ab initio vitiosum est tractu temporis convalescere non potest).*

Komisioni i Prokurimit Publik në interpretim sistematik (domethënien e drejtë të normës juridike, duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), gjykon, se ndodhet para kushtit të konstatimit prima facia të një akti administrativ absolutisht të pavlefshëm dhe në cilësinë e organit administrativ më të lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, parashikuar nga neni 24/1 i ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, konstaton, se akti administrativ vendimi i KSHA nr. 340/1, datë 06.06.2024 të Komisionit Shqyrtimit të Ankesës, është akt absolutisht i pavlefshëm në kuptim të nenit 108 të K.Pr.A i cili si një akt administrativ individual, i shtrin efektet *inter partes* dhe në asnjë rast *erga omnes*. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se hapat proceduralë të ndjekur nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit objekt - prokurimi cenojnë në thelb jo vetëm garancitë procedurale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, por njëherazi cenojnë edhe parimin e sigurisë juridike. Në jurisprudencën e saj *Inter Allia*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014, datë 17.03.2014, është shprehur se “*Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin*”. Sa më sipër, KPP gjykon, se në rastin konkret parimi i sigurisë juridike në kuptimin material të tij, konsiderohet edhe moscenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi. Akoma më tej, në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese *Inter Allia* në vendimin 15/2010 ka theksuar se “*parimi i shtetit të së drejtës i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës nënkupton veprimin e të gjithë institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për atë që lejon Kushtetuta dhe ligji duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore*”. Sa më sipër, KPP, gjykon, se vendimi për rivlerësimin kryesisht të procedurës së prokurimit nga KSHA e autoritetit kontraktor është në kundërshtim me hapat proceduralë që parashikon LPP, ndaj duhet të anulohen si vendim i dalë në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik dhe duke qenë se nuliteti i aktit më sipër nuk prodhon asnjë pasojë që nga fillimi, rrjedhimisht, rivlerësimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik në datë 10.06.2024, për procedurën e mësipërme të prokurimit do të konsiderohet i pavlefshëm dhe procedura e prokurimit duhet të rikthehet në gjendjen juridike sipas vlerësimit të datës 29.05.2024.

Sa më sipër, KPP gjykon, se arsyet shitesë të skualifikimit të shprehura në aktin e trajtimit të ankesës, me nr. 340/1, datë 06.06.2024 e më pas rivlerësimi i procedurës dhe çdo veprim tjetër procedural, janë kryer në shkelje të parashikimeve ligjore dhe KPP i tërheq vëmendjen

autoritetit kontraktor, për mosrespektim të dispozitave ligjore në fuqi, lidhur me hapat proceduriale të procedurës së prokurimit.

III.3. Për sa i përket ankmit ankimin elektronik A/2024/4221, dhe nr. Protokoli 1594/2024, datë 14.06.2024, të operatorit ekonomik “AEK Munella” SHPK, nga verifikimi në Sistemin e Ankesave Elektronike, rezultonte se ankesa e operatorit ekonomik “AEK Munella” SHPK, është dorëzuar me të meta, pasi është paraqitur i njëjti dokument bankar që vërtetin pagesën për ankimin elektronik me nr. A/2024/4175, datë 06.06.2014 dhe me nr. protokoli 1465/2024 datë 07.06.2024 e operatorit ekonomik “AEK Munella” SHPK.

Pra, sa më sipër, rezulton se për ankimin elektronik A/2024/4221, dhe nr. Protokoli 1594/2024, datë 14.06.2024, operatori ekonomik “AEK Munella” SHPK, nuk ka dorëzuar mandatin bankar që provon pagesën e tarifës, ku referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor. Një prej elementeve të domosdoshme për paraqitjen e ankesës është edhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 3, 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendosi**

1. Të mos pranojë ankimin elektronik me nr. A/2024/4175, datë 06.06.2014 dhe me nr. protokoli 1465/2024 datë 07.06.2024 e operatorit ekonomik “AEK Munella” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-04311-05-10-2024, me objekt: “Blerje karburanti, për nevojat e Agjencisë së Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes”, me fond limit 8,676,667 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 24.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes.
2. Të mos pranojë ankimin elektronik me nr. A/2024/4221, dhe nr. Protokoli 1594/2024, datë 14.06.2024 të operatorit ekonomik “AEK Munella” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik “AEK Munella” SHPK, për ankimin elektronik me nr. A/2024/4175, datë 06.06.2014 dhe me nr. protokolli 1465/2024 datë 07.06.2024.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**